Në **mbështetje të Ligjit** Nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Udhëzuesin Kombëtar të Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 798 datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullore “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, Ligjin Nr. 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”, Ligjit Nr. 9010 datë 13.02.2003 “Administrimit Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”, Ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar si dhe në aktet ligjore/nenligjore në fuqi

Mbetje me KODIN: KODI 18 01 01, 18 01 03, 18 01 04 sipas Katalogut shqiptar të mbetjeve, ose ekuivalente sipas **VKM 798, Date 29.09.2010** do të asgjësohen sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”: **Shtojca 3)** “Metodat për trajtim dhe asgjësim”, **Pika 2) Me autoklavim, Shtojca 5)** “Standarte teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”. Kjo metodë e mbështetur në Udhëzimin Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bera në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni 7.1, Tabela 1.

Mbetjet me KODIN 18 01 02 dhe 18 01 09 ose ekuivalente sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, do të asgjësohen sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” **Shtojca 3)** “Metodat për trajtim dhe asgjësim”, **Pika 1) “Incenerim”, Shtojca 5)** “Standarte teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”. Kjo metodë e mbështetur në Udhëzimin Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bera në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni 7.1, Tabela 1.

2. Tërheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Mbetjet duhet të merren nga kontraktuesi pranë Autoritetit Kontraktor me mjete të posaçme në pronesi të sipërmarrësit dhe me abalazhimin perkates në përputhje me standartet për mbetjet e rrezikshme spitalore duke respektuar standartin sipas VKM 798, dt.29.09.2010, “ *Per administrimin e mbetjeve spitalore*” dhe Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore”.

3. “Asgjësimi duhet të realizohet në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullore “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja), si dhe Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore.”.

4. Qeskat dhe kontenierët duhet të mbulohen nga sipërmaresi dhe në rastin kur janë plastike shumë përdorimëshe, duhet të sigurohet larja dhe dizinfektimi i tyre në çdo ripërdorim. Për arsye të hapësirave fizike dhe për një menaxhim sa më të mirë të shërbimit, kontenieret duhet të jenë me kapacitet si vijon:

*Mbetje infektive prerese dhe shpuese me kapacitet rreth 1 L, 3L, 6L.

-
- *Mbetje infektive me kapacitet rreth – 40L, 60L
 - *Mbetje anatomike me kapacitet rreth – 40L
 - *Mbetje farmaceutike me kapacitet rreth – 20L deri ne 60L
 - * me kapacitet nenkuptohet qe ka nje tolerance minus/plus 5% te parashikuar me siper.**

Sipas percaktimeve te bera ne VKM 798, dt.29.09.2010 “Per administrimin e mbetjeve spitalore”, si dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”, te gjithë kontenieret qe perdoren nga spitali duhet te merren nga firma dhe te behet dezinfektimi i tyre prej saj.

5. Operatori Ekonomik duhet të pajisi A.K. me sinjalistikë dhe tabela sinjalizuese të cilat tregojnë prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambjentin/ambjentet përkatëse të Autoritetit kontraktor, në bazë të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”.

6. Operatori ekonomik dhe Perfaqesuesit e Spitalit per cdo dorezim mbetjesh spitalore tek operatori per asgjesim do te mbajne “Dokumentin e dorezimit te mbetjeve te Rrezikshme” sipas VKM Nr. 371 date 11.06.2014 “Per miratimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te dokumentit te dorezimit te tyre”. Saktësia e plotësimit të dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme", do të sigurohet nëpërmjet dokumentit të peshimit dhe Operatori duhet te mbaje evidencat perkatese si dhe te dhenat e ciklit te perpunimit per cdo asgjesim.

7. Mbetjet e vecanta të vendosura në ambalazh do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të të dy palëve nga një peshore, e cila duhet të disponohet nga Operatori Ekonomik. Mbas cdo terheqje te mbetjeve, do te hartohet proces verbali për sasinë e peshuar në tre kopje dhe nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktor. Dy kopje mbahen nga AK dhe një kopje e merr kontraktuesi. Pesha e mbeturinave të rrezikshme spitalore do të llogaritet neto duke zbritur peshën e ambalazhit.

8. Operatori ekonomik, duhet te instaloje të paktën dy frigorifere në ambientet e SUT te pershtatshem per ruajtjen e mbetjeve te rrezikshme te buta dhe te ngurta, deri ne momentin e transportimit për ne impiantin e asgjesimit. Te sigurohet dezinfektimi i mire i frigorifereve dhe ambientit brenda dhe përreth vendit ku ruhen mbetjet.

9. Tërheqja e mbetjeve spitalore te behet çdo dite, çdo dy dite e çdo jave, ne varësi te fluksit te mbetjeve por dhe sigurimit te kushteve frigoriferike. Operatori ekonomik kontraktues, te caktojë një person kontakti qe do te mbaje lidhje me SUT për çdo problem dhe emergjence.

10. Bazuar ne eksperiencen e vitit 2021, sasia mesatare e mbetjeve spitalore eshte:
rreth 181 kg ne dite ose 66,040 kg per 365 dite.

Sasia eshte e perllogaritur sipas aktrakordimeve mujore dhe e ndare sipas kodeve si me poshte:

Kodi 180101/180103 = 59,495 kg per 365 dite

Kodi 180102 = 6545 kg per 365 dite

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT” për një periudhë 36 mujore të perlllogaritura sipas kërkesave të Ak dhe sipas kushtit që kjo Marrëveshje do të nderpritet në rast se MSHMS do të zhvillojë një studim dhe procedurë prokurimi të përqendruar për këtë shërbim specifik me rëndësi kombëtare

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj

Sasia: **181 kg në ditë ose 198,120 kg për 3 vite**

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT” për një periudhë 36 mujore të perlojaritura sipas kërkesave të Ak dhe sipas kushtit që kjo Marrveshje do të nderpritet në rast se MSHMS do të zhvillojë një studim dhe procedurë prokurimi të përqendruar për këtë shërbim specifik me rendesi kombëtare.

Detyrat: OE do të marrin përsipër të kryejnë shërbimin e kërkuar për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për Spitalin Universitar të Traumës sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në këto dokumenta tenderi.

Shpërndarja: Ak do të njoftojë OE të suksesshem për lidhjen e kontratës së shërbimit sa herë që të ketë nevojë dhe brenda fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori Ekonomik duhet të disponoje Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore te tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe liçencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që te përfshijnë mbetje spitalore me kod 18 01 01; 18 01 03 dhe mbetjet me kod 18 01 04 ku procedura e asgjësimit të jetë sterilizim me Autoklavim ose teknologji ekuivalente.

2. Operatori ekonomik duhet të disponoje Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

3. Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe te paraqese Çertifikatë SSH/ EN ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilesisë); Çertifikatë SSH/ EN ISO 14001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Mjedisit); Çertifikatë BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë te punetoreve në punë) dhe Çertifikatë ISO 39001:2012 (Mbi Sistemin e menaxhimit të sigurise se trafikut rrugor) per fushen e veprimtarise objekt i kesaj kontrate;

Shënim: Në Zbatim të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018, të gjitha çertifikatat e cilësisë duhet të jenë të vlefshme dhe te lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilësisë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Te perkthyer dhe te noterizuar);

4. Operatori ekonomik duhet te paraqese Akt Miratimin Higjeno –Sanitar respektiv per objektet ku ushtron aktivitetin e sterilizimit dhe incenerimit te leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);

Shënim: Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike secili prej operatoreve duhet te permbushë kriteret e kerkuara me siper.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej jo më pak se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.

- *Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

2. Operatori duhet të ketë në pronësi /qira, minimalisht 3 (tre) automjete të izoluar hermetikisht, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjen dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore (në përputhje me pika 8.8/c dhe Shtojcës nr.4 të VKM Nr.798 datë 29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bera në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni: 9.3.3 ‘Automjetet/anijet e grumbullimit’). Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të plotësojë dhe paraqesë Formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës 9, dhe të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Për automjetet në pronësi: Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe policia e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto të mjeteve ku të duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.
- Për automjetet që nuk janë në pronësi: Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe policia e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me fotot dhe Akt – Miratimet Higjenosanitare;

Shënim: Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore, dokumentat provuese të mësipërme duhet të paraqiten pranë AK nga ofertuesi i kualifikuar i renditur i pari jo më vonë se 3 dite nga përfundimi i procedurës së vlerësimit të ofertave, së bashku me të gjitha dokumentat e përcaktuara në pikën 6 të nenit 26 të VKM nr.285/2021 Për RrPP.

3. Operatori Ekonomik duhet ta ketë jo më pak se 10 persona të punësuar të siguruar për periudhën Tetor 2021 e në vijim. Për këtë OE duhet të plotësojë dhe paraqesë Formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës 9, dhe të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme dhe
- Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Shënim: Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore, dokumentat provuese të mësipërme duhet të paraqiten pranë AK nga ofertuesi i kualifikuar i renditur i pari jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procedurës së vlerësimit të ofertave, së bashku me të gjitha dokumentat e përcaktuara në pikën 6 të nenit 26 të VKM nr.285/2021 Për RrPP.

4. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve duke pasur të punësuar dhe regjistruar në listpagesa minimalisht nga Tetor 2021 e në vijim ose me kontrate shërbimi:

- Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Për këtë OE duhet të plotësojë Formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës 9, dhe të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër:

- Librezë pune
- CV përkatëse
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme
- Diplomë

Shënim: Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore, dokumentat provuese të mësipërme duhet të paraqiten pranë AK nga ofertuesi i kualifikuar i renditur i pari jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procedurës së vlerësimit të ofertave, së bashku me të gjitha dokumentat e përcaktuara në pikën 6 të nenit 26 të VKM nr.285/2021 Për RrPP.

5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera impiantet për trajtimin me sterilizim dhe asgjësimin me incenerim të secilës kategori të prokuruar nga AK të mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se Nr. 798 datë 29.09.2010 për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të plotësojë Formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës 9, dhe të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësive ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- Impiantet për trajtimin me sterilizim dhe asgjësimin me incenerim, njëkohësisht makineria për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve duhet të jenë të pajisur me Leje Mjedimore të tipit A (III.1.C) dhe/ose të tipit B (III.1.B) ose të jenë pasqyruar në Lejet Mjedimore të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- Katalog ose skedë teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë

Shënim 1: Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore, dokumentat provuese të mësipërme duhet të paraqiten pranë AK nga ofertuesi i kualifikuar i renditur i pari jo me vonë se 3 dite nga përfundimi i procedurës së vlerësimit të ofertave, së bashku me të gjitha dokumentat e përcaktuara në pikën 6 të nenit 26 të VKM nr.285/2021 Për RrPP.

Shënim 2: KVO do te verifikoje ne terren te dhenat per impiantet te paraqitura nga ofertuesit si me siper dhe realizimin e nje cikli pune nga seicili impiant, duke lajmëruar minimalisht 24 h përpara. Mosfunksionimi i impiantit gjatë verifikimit të KVO në terren, do të përbëjë shkak skualifikimi.

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te licensuar per depozitim e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave.. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

- Kontratë me subjektin e licensuar per depozitim e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi
- Minimalisht 2 (dy) Dokumenta të Transferimit të Mbetjeve të plotësuar nga ofertuesi me subjektin e licensuar gjatë 3 muajve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës ku të jetë pasqyruar depozitimi i seicilit produkt që del nga asgjesimi/trajtimi sipas VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"

7. Operatori duhet te furnizojë kontenitoret sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:

- Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01: në 3 përmasa që fillon nga 1L
- Kontenier plastike të ripërdorshëm të mëdhenj me qese plastmasi njëpërdorimësh për anatomiket 18 01 02 dhe infektivet 18 01 03: në 3 përmasa që fillojnë nga 30 L deri ne 60 L.
- Kontenitor kartoni njëpërdorimësh 60 L

Per te provuar plotesimin e ketij kriteri operatori duhet te paraqese per seicilin lloj kontenitori:

- Fature blerje ose zhdoganimi
- Katalog ose skede teknike
- Certifikimin e aprovimit te tipit te ambalazhit per seicilin lloj kontenitori.
- Operatori duhet te sjelle per verifikim ne ambientet e Spitalit jo me vonë se dita dhe ora e hapjes se ofertave, nga nje moster per seicilin lloj kontenitori të etiketuar në përputhje me VKM Nr. 798 date 29.09.2010

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit si dhe do të verifikojë në vend funksionimin e impianteve të paraqitura, duke asistuar realizimin e një cikli pune nga seicili.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm

<p>për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1	_____

të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës.	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi.	Po [] Jo []

<p>Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>	
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Formulari i Njoftimit të Skualifikimit 2

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve në Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

²Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-t*

Vlera

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Vlera

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej _____ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

[Titullari i Autoritetit/entit Kontraktor]

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 3

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

³ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____

e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it* *arsyet*

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

Etj. _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

[Drejtuesi i Autoritetit /Entit Kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT⁴)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
Numri i NIPT-it

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
Numri i NIPT-it

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

⁴ Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

Seksioni III Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Ky Seksion përmban :

Shtojca 15: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 16: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 17: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 18: Draftmarrëveshje ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 19: Draftmarrëveshje ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 15

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

1.1 Përkufizimet

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1.1 Kontrata

1.1.1.1 "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

1.1.1.2 "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

1.1.1.3 "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

1.1.1.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

1.1.1.5 "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

1.1.1.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

1.1.1.7 "Termet e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

1.1.1.8 "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

1.1.1.9 "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

1.1.1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1.1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.1.2 Palët e Kontratës

1.1.2.1 "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

1.1.2.2 "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.

1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimin Shërbimeve objekt kontrate.

